



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

VENDIM

Nr. 274, datë 18 /03/2013

“Për

hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetare
- Rezana KONOMI zv/Kryetare
- Servete GRUDA Anëtare
- Koço BROKA Anëtare
- Iva ZAJMI Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Mbi shqyrtimin e propozimit për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës .

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi shqetësimet për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur shqetësime mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës pasi disa firma janë duke bashkëpunuar gjatë pjesmarrjes në prokurimet publike si dhe duke mbuluar njëra-tjetrën me paraqitjen e ofertave në masën 99% të Fondit Limit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë për hyrjen e operatorëve të tjerë në këtë treg.

Sipas shqetësimeve të hasura në këtë treg, mënyra kryesore e bashkëpunimit mes konkurrentëve që mund të ketë sjellë kufizime të konkurrencës në treg lidhet me disa shenja të bashkëpunimit si përgatitja e ofertave nga punonjës të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin; përdorimi i skemës së ofertës së mbuluar; ndarja e tregut (klientëve në këtë rast autoritetet kontraktore) etj.

Ky bashkëpunim pretendohet se ka ndodhur në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga disa autoritete kontraktore.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marreveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II. Periudha e Hetimit do të jetë nga Janari deri në Dhjetor 2012.

- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 25.05.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Iva ZAJMI

(_____)
Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)
Zv/Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R